



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 10.02.2020

**PROPOZIME PËR AMENDAMENTE
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR
STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Drejtuar : **Zotit GRAMOZ RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes amendamentin e mëposhtëm në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar për tekstin integral të miratuar nga Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut:

1. Në nenin 8 (që ndryshon nenin 152 të ligjit bazë), pika 1, në fjalë e dytë, pas fjalëve “...raport të arsyetuar...”, shtohen fjalët “....bazuar në faktet dhe provat e mbledhura deri në atë moment...”

DEPUTETJA PROPOZUESE

AURORA MARA

Argumentimi për amendamentet e propozuara në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” për tekstin integral të miratuar nga Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Nëpërmjet këtij amendamenti propozohet një rregullim në fjalinë e dytë të pikës 1, të nenit 8 të projektligjit (që ndryshon nenin 152 të ligjit aktual).

Pas shtesës së togjalëshit të propozuar fjalia e dytë e pika 1 e këtij neni, lexohet me këtë përmbajtje:

Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen, se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar i paraqet Këshillit përkatës, raport të arsyetuar, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura deri në atë moment, për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.”

Ky amendament ka si qëllim parashikimin e mekanizmave në dispozicion të Inspektorit të Lartë Drejtësisë për kryerjen një procesi sa më objektiv, në rastin e procedurës së përsheptuar të bazuar në provat dhe faktet dhe mbledhura deri në atë moment.

DEPUTETJA PROPOZUESE

AURORA MARA